

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Salih Toplica, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fatime Hasani-Ruhani, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve H. K., nga fshati V., komuna e Lipjanit, A. M., nga fshati D. e M., komuna e Lipjanit, L. Z., nga fshati G., komuna e Lipjanit dhe A. S., nga fshati R., komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 327 par. 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit Publik të Qarkut Prizren dhe të akuzuarve H. K. dhe L. Z., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr. 149/2011 datë 04.08.2011, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23 maj 2012, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e pjesshëm të ankesës së të akuzuarve H. K. dhe L. Z. dhe sipas detyrës zyrtare në raport me të akuzuarin A. M., aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prizren, P.nr. 149/2011 datë 04.08.2011, në pjesën ndëshkuese ndryshohet vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme të akuzuarve , duke ua marr të vërtetuara dënimet me gjobë të përcaktuara nga gjykata e shkallës së parë , të njëjtit ua kushtëzon dhe ato nuk do të ekzekutohen po qe se të akuzuarit në afat prej një (viti) pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nuk kryejnë vepër tjetër penale .

II. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut Prizren dhe aktgjykimi i shkallës së parë në pjesën liruese, në raport me të akuzuarin A. S.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prizren, me aktgjykimin P.nr. 149/2011 datë 04.08.2011, të akuzuarit H. K., A. M. dhe L. Z. i ka shpallur fajtorë për veprën penale furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 327 par. 1 të KPK dhe për këtë vepër i ka gjykuar të akuzuarin H. K., me dënim me gjobë në shumë prej 500 €, të akuzuarin A. M.

me dënim me gjobë në shumë prej 400 € dhe L. Z. me dënim me gjobë në shumë prej 500 €. Në dënimet e shqiptuara iu është llogaritur edhe koha e kaluar në ndalim prej datës 07.05.2011 gjer më datën 09.05.2011. Të akuzuarit i ka obliguar që dënimin me gjobë të paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e në rast të mospagese e njëjta do t'u zëvendësohet me dënim me gjobë, duke llogaritur çdo 15 € të filluar me një ditë burgimi. U ka shqiptuar edhe dënimet plotësuese ashtu nga i akuzuari H. K. janë konfiskuar 75 copë fishekë të gjuetisë të kal. 12 mm, nga i akuzuari A. M. 50 fishekë të të njëjtit kalibër dhe nga i akuzuari L. Z. 75 fishekë të gjuetisë të kal. 12 mm si objekt i veprës penale. Me të njëjtin aktgjykim i akuzuari A. S., konform nenit 390 pika 3 të KPPK, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale furnizimi, transporti, prodhimi , këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 327 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK.

Kundër këtij aktgjykimi ankesa kanë ushtruar:

-Prokurori Publik i Qarkut Prizren për pjesën liruese për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, dhe,

-të akuzuarit H. K. dhe L. Z., ankesa e përbashkët për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarve t'u shqiptohen dënime më të buta, të lirohen nga akuza apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Për seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, janë informuar të akuzuarit, mbrojtësit e tyre dhe Prokurori i Shtetit. Në seancë nuk mori pjesë askush, prandaj seanca u mbajt konform dispozitës së nenit 410 par. 4 të KPPK. Prokurori i Shtetit, me parashtresën PPA.nr. 392/2011 datë 17.11.2011, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të aprovohet ndërsa ajo e të akuzuarve të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 415 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarve H. K. dhe L. Z. është e bazuar vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ndërsa ajo e Prokurorit Publik është e pabazuar.

Përkitazi me pjesën ndëshkuese, në ankesën e përbashkët të të akuzuarve H. K. dhe L. Z. pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse në

të nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare ndërsa arsyet e paraqitura janë të paqarta dhe në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve. Ndërsa, në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut për pjesën liruese theksohet se aktgjykimi në këtë pjesë është përfshirë me shkelje esenciale nga neni 403 par. 1 pika 12 të KPPK, sepse aktgjykimi është i pakuptueshëm dhe kundërthënës me arsyet e dhëna, në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare kurse ato të paraqitura janë të paqarta dhe kundërthënëse me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Në ankesat e ushtruara nuk theksohet se ku dhe në çfarë manifestohen këto shkelje përveç që citohet dispozita e nenit 403 par. 1 pika 12 të KPPK. Mirëpo, nga përmbajtja e ankesës së të akuzuarve rezulton se këto pretendime ndërlidhen me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Gjykata Supreme, vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara e as që ka shkelje tjera esenciale për të cilat sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së enti 415 të KPPK, kujdeset kjo Gjykatë.

Aktgjykimi i shkallës së parë edhe dispozitivi i tij është i qartë dhe konkret, në të janë përshkruar veprimet e detajuara inkriminuese të të akuzuarve, nuk ka kundërthënie qoftë me vetveten, qoftë me arsyetimin. Në arsyetimin e tij janë dhënë arsye e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të cilat jo vetëm që janë vërtetuar drejt por ato janë arsyetuar në mënyrë të plotë.

Në ankesën e të akuzuarve theksohet se gjykata e shkallës së parë ka shkelur edhe ligjin penal sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se ata kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe në këtë rast gjykata e shkallës së parë është dashur që t'i liroj nga akuza.

Gjykata Supreme gjen se as pretendimi i sipër cekur nuk qëndron.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes dhe aktgjykimi i ankimuar, të gjithë të akuzuarit pra H. K., A. M. dhe L. Z., gjatë gjithë fazave të procedurës penale kanë pranuar fajësinë, pranim ky i cili gjen mbështetje edhe në provat tjera në këtë çështje penale, prandaj në kontest të gjendjes së këtyre faktike e cila gjatë gjithë fazave të procedurës penale nuk është kontestuar nga të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar edhe ligjin penal. Prandaj, pretendimet nga ankesa qartazi dalin si të pabazuara.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata Supreme gjen se pretendimet nga ankesa janë të bazuara.

Në ankesën e të akuzuarve H. K. dhe L. Z. theksohet se dënimet e shqiptuara janë tejet të ashpra dhe nuk janë në proporcion me rrezikshmërinë e veprës së kryer penale. Kështu, sipas ankesës duke pasur parasysh këto rrethana si dhe rrethanat tjera siç janë sjelljet e tyre të mëhershme dhe gjatë procedurës penale, rrethana këto të cilat po të vlerësoheshin drejt do të ndikonin në shqiptimin e një dënimi më të butë me të cilën do të arrihet qëllimi i ndëshkimit.

Gjykata e shkallës së parë, konform dispozitës së nenit 64 të KPK, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, kështu si rrethana lehtësuese të akuzuarve ua mori për bazë se janë familjar, se i akuzuari H. K. është i martuar, babë i pesë fëmijëve, i akuzuari A. është baba i dy fëmijëve si dhe i akuzuari L. babë i dy fëmijëve, gjendjen e tyre të vështirë ekonomike, se gjer më tani asnjëri nuk ka rënë në konflikt me ligjin, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë e që nënkupton edhe pendimin e tyre për veprat e kryera penale.

Konstatimin e këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit e pranon edhe kjo Gjykatë, mirëpo, bazuar në faktin se gjykata e shkallës së parë, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve me të drejt ua ka vlerësuar si rrethanë veçanërisht lehtësuese, pastaj mbështetur në faktin se të akuzuarit posedonin leje për mbajtjen e armës për të cilën kishin blerë municionin, se në Kosovë nuk kishte shitore të autorizuar akoma për shitjen e municionit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprimeve të të akuzuarve e bën të ulët, e që konform nenit 66 dhe 67 lidhur me nenin 42,43 dhe 44, të KPK, justifikojnë edhe kushtëzimin e dënimit me gjobë, e që sipas bindjes së gjykatës në rrethana të këtilla edhe vetëm me kërcënim për dënim do të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal në të gjitha segmentet e t'ia, konform nenit 34 të KPK.

Duke pasur parasysh se i akuzuari A. M. nuk ka ushtruar ankesë, Gjykata Supreme konform dispozitës së nenit 419 të KPPK, aplikoi institutin juridik *benefecium kohaesione* sepse në rastin konkret kjo Gjykatë çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të akuzuarve të tjerë e që nuk janë të natyrës personale, ato shkojnë në dobi edhe të akuzuarit A. M., i cili nuk ka paraqitur ankesë.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 426 të KPPK, u vendos si nën pikën I të këtij dispozitivi.

II. Në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut për pjesën liruese, përkritazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale është folur më lartë dhe nuk ka nevojë që të përsëriten.

Përkitazi me bazë ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në ankesë theksohet se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari A. S. ka qenë së bashku me të akuzuarit të tjerë në Shqipëri ku në qytetin e Durrësit bashkërisht kanë blerë 200 fishekë të gjuetisë të kal. 12 mm dhe se i akuzuari A. ka qenë në dijeni për furnizimin dhe transportimin e municionit gjatë gjithë kohës. Kjo gjendje është vërtetuar nga vetë deklarata e të akuzuarit i cili ka pohuar se ka qenë në shoqëri me të akuzuarit të tjerë dhe se të gjithë kanë qëndruar së bashku nuk janë ndarë dhe gjatë kthimit për në Kosovë i njëjti nuk ka raportuar sasinë e municionit të cilën ka pasur në veturë. Theksohet se në praninë e këtyre provave i akuzuari është dashur që të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Konkludimi i gjykatë së shkallës së parë përkitazi me dashjen e të akuzuarit A. për të kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, me asgjë nuk mund të vihet në dyshim sepse fakti se i akuzuari nuk është kryerës i veprës penale, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të sigurt. Kështu, nuk është kontestuese se të akuzuarit ditën kritike kanë udhëtuar për në Shqipëri me veturën e të akuzuarit A. të markës “Mercedes” me targa të regjistrimit 4.. – KS – 05.. të cilën e drejtonte i akuzuari A.. Po ashtu, nuk është kontestuese se të akuzuarit H. K., A. M. dhe L. Z. në qytetin e Durrësit kanë blerë municion për armë të gjuetisë. Nuk është kontestuese se në pikën doganore me të hyrë në Kosovë në veturën e të akuzuarit A. është gjetur municioni i përmendur. Po ashtu, nuk është kontestuese se të gjithë të akuzuarit janë anëtarë të Shoqatës së Gjuetisë.

Me këtë rast asnjë provë e administruar nuk çon në konkludim se i akuzuari A. është kryerës i kësaj vepre penale. I njëjti kategorikisht mohon veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa nga ana tjetër, të akuzuarit tjerë kanë pranuar fajësinë se municionin, i cili ka qenë objekt akuze kanë blerë për nevojat e veta, në qytetin e Durrësit, sepse janë anëtarë të Shoqatës së Gjuetarëve. Vetë fakti se i akuzuari A. e ka drejtuar veturën e tij, se ata ishin së bashku kur të akuzuarit të tjerë kanë blerë municionin, nuk do të thotë a priori se në rastin konkret ekziston bashkëkryerje, meqë veprimet e të akuzuarve të tjerë ishin individuale të cilat nuk mund t'i mvishen të akuzuarit A. Po ashtu, edhe fakti se i akuzuari nuk e ka deklaruar municionin në pikën doganore nuk do të thotë se dashja e tij ka qenë e përbashkët që ta bëjë transportimin e municionit të cilën të akuzuarit të tjerë kanë blerë për nevojat e veta. Të gjitha këto rrethanat nuk japin bazë të mjaftueshme që i akuzuari të shpallet fajtor, sepse në shkresat e çështjes nuk ka asnjë provë e cila do të vërtetonte një gjë të tillë, ndërsa nga ana tjetër as Prokurori në këtë drejtim nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete, e cila në mënyrë të sigurtë do të vërtetonte fajësinë e të akuzuarit A., prandaj, gjykata e shkallës së parë, drejtë konkludon se në veprimet e të akuzuarit A. nuk sajohen elementet e veprës penale për të cilën ka qenë i akuzuar. Nga rrethanat e cekura më lartë, dhe ato të theksuara në aktgjykimin e ankimuar dalin si të pabazuara

pretendimet nga ankesa e Prokurorit Publik, prandaj konform dispozitës së nenit 423 të KPPK, u vendos si në pikën II të këtij dispozitivi.

Ankesa e përbashkët e të akuzuarve H. K. dhe L. Z., në pjesën që ka të bëjë me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike është hedhur si e palejuar pasi që të akuzuarit gjatë gjithë fazave të procedurës kanë pranuar fajësinë (neni 402 par. 2 të KPPK).

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 426 dhe 423 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Ap.nr.392/2011, më 23 maj 2012

Procesmbajtësja,
Fatime Hasani-Ruhani,

Anëtarët e kolegjit,
1. _____
Emine Mustafa
2. _____
Salih Toplica

Kryetari i kolegjit,
Avdi Dinaj